



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

midis

Universitetit Bujqësor të Tiranës

përfaqësuar nga

Rektori,
Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU
Rr. Pajsi Vodica, Kodër-Kamëz, Tiranë
Shqipëri

dhe

Universitetit "Barleti"

përfaqësuar nga

Rektore,
Prof. Dr. Suzana Guxholli
Rruga "Frang Bardhi" Tiranë,
Shqipëri

Parathënie

Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Universiteti Barleti dëshirojnë të lidhin një marrëveshje bashkëpunimi në fushat e kërkimit shkencor dhe edukimit. Bashkëpunimi do të bazohet në frymën e barazisë dhe reciprocitetit dhe do të synojë të forcojë marrëdhëniet dhe të promovojë bashkëpunimin në fusha me interes të përbashkët.

Neni 1

Fushat e bashkëpunimit

Bashkëpunimi do të përfshijë aktivitetet që vijojnë:

- ❖ shkëmbime të vizitave të anëtarëve të stafit shkencor akademik dhe administrativ
- ❖ shkëmbime të studentëve të të gjitha niveleve të studimit,
- ❖ zhvillim dhe zbatim të projekteve të përbashkëta kërkimore,
- ❖ organizim të aktiviteteve të përbashkëta akademike dhe shkencore të tilla si: konferenca shkencore, simpoziume, workshope, shkolla verore, kurse trajnimi , leksione, simpoziume, etj.,
- ❖ shkëmbim të materialeve shkencore, botimeve në revista shkencore dhe informacione të tjera të përshtatshme, me interes në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.
- ❖ forma të tjera të shkëmbimit akademik sipas pëlqimit të përbashkët.

Neni 2

Zbatimi i Marrëveshjes

Zbatimi i këtyre aktiviteteve mund të rregullohet nga kjo marrëveshje ose nga marrëveshje individuale midis fakulteteve, të cilat do të bashkëpunojnë marrëveshjes ekzistuese të bashkëpunimit midis palëve. Detajet financiare të marrëveshjes së bashkëpunimit do të qartësohen përpara ose gjatë fillimit të bashkëpunimit. Për realizimin e të gjithë aktiviteteve, mund të përdoren edhe fonde nga burime të jashtme të përshtatshme. Universiteti që paraqet një propozim projekti është përgjegjës për sigurimin e fondeve të nevojshme për zbatimin e tij.

Neni 3

Në parim, bashkëpunimi mund të përfshijë të gjitha fakultetet e Universitetit Barleti dhe të gjitha fakultetet e Universitetit Bujqësor të Tiranës. Fushat e bashkëpunimit të identifikuar dhe të dakortësuara, do të përfshijnë cilindo program që ofron secila palë, në përputhje me misionin që ka secili institucion dhe me objektivat e kësaj marrëveshje. Secila palë angazhohet të japë kontributin e saj në fushat e mesimdhënies, kërkimit, shkëmbimit të stafit akademik dhe studentëve, zhvillimit të programeve të reja që sjellin përfitime për të dyja palët etj.

Neni 4

Të dy institucionet, zotohen për të gjetur mundësira të përshtatshme për financimin e aktiviteteve të përcaktuara në këtë marrëveshje. Secili universitet duhet të angazhojë fonde të mjaftueshme nga buxheti i tyre baze për realizimin me sukses të kësaj marrëveshje dhe në rast të fondeve të pamjaftueshme mund të sigurojnë fonde edhe nga burime të tjera.

Neni 5

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi do të jetë e vlefshme për një periudhë prej 5 vjetësh dhe ka një vlefshmëri për periudhën / / 2024_ deri në / / 2029. Marrëveshja do të zgjatet automatikisht për një vit me rradhë, nëse nuk është anuluar prej të paktën njëres palë brenda gjashtë muajsh me shkrim. Çdo pezullim duhet të përcaktojë hollësitë e pezullimit të marrëveshjeve, siç përcaktohet më sipër në pikën 2. Për aq sa është e mundur, këto marrëveshje bashkëpunimi midis institucioneve do të vazhdojnë deri në periudhën e rënë dakort midis palëve me të drejtën e rinovimit pas mbarimit të afatit të vlefshmërisë me pëlqimin e të dy palëve.

Neni 6

Marrëveshja e Bashkëpunimit mund të ndryshohet në çfarëdo lloj kohe përmes shkëmbimit të letrave midis përfaqësuesve të marrëveshjes së përbashkët të të dy universiteteve.

7. Në rastet e konfliktit ose mosmarrëveshjes, të dy palët duhet të përpiqen për të zgjidhur problemin për të bërë lëshime të përbashkëta, po të jetë e nevojshme. Nëse të dyja palët konfirmojnë se një zgjidhje e përbashkët është e pamundur, atëherë Marrëveshja e Përbashkët do të anulohet automatikisht në ditën më të parë të mundshme.

Neni 7

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është përgatitur në gjuhën shqipe në 3 kopje. Marrëveshja hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga përfaqësuesit e institucioneve partnere.

Për Universitetin Bujqësor të Tiranës

Për Universitetin "Barleti"

Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU .
Rektor

Prof. Dr. Suzana GUXHOLLI
Rektore

Data: 08/03 /2024



Data: 08 /03 /2024